



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2058/9 prot.

Datë 03.08.2026

V E N D I M
Nr.936/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.08.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër 2058/2026 prot., datë 26.06.2026, i operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-82309-04-16-2026, me objekt: “Loti 2: “Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë”, me fond limit 99,351,968.95 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 08.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, me NIPT 91413010N dhe adresë Njësia Bashkiake nr.3, Rruga Martin Camaj, Pallati MGB, Kati I, Apartamenti nr. 5, Shkalla 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a me adresë Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr. 6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave

nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.04.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-82309-04-16-2026, me objekt: “Loti 2: “Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë”, me fond limit 99,351,968.95 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 08.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 08.06.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 12.06.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

BOE Pastrime Silvio & Rada Oil Industry	77,546,126 lekë	Skualifikuar
Fusha	97,906,939 lekë	Kualifikuar
Rej	98,540,492.92 lekë	Skualifikuar
Alko Impex Construction	99,333,431.89 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 24.06.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Në datën 26.06.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2026/6888 dhe nr.2058/2026 prot, datë 26.06.2026 e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2058/1 prot, datë 29.06.2026.

II.7. Në datën 29.06.2026, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK, ka paraqitu shkresën me përmbajtje “*Operatori Pastrime Silvio tërhiqet nga ankesa me nr. A/2026/6888.*”, shkresë e protokolluar me tonën me nr.2058/2 prot., datë 29.06.2026.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën me nr. 3710/prot., datë 03.07.2026, me objekt: “Kërkesë për konfirmim të tërheqjes nga ankesa”, është përcjellë nga autoriteti kontraktor informacioni i kërkuar operatorit ekonomik ankimues, protokolluar me tonën me nr. 2058/3 prot., datë 06.07.2026.

II.9. Autoriteti kontraktor me shkresën nr.3710 prot., datë 09.07.2026, me objekt “*Kërkesë për asistencë teknike*”, protokolluar me tonën me nr.2058/4 prot., datë 10.07.2026 i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik duke i kërkuar informacionin si më poshte: [...] *A rezulton një dokument i nënshkruar nga ankimuesi në lidhje me tërheqjen nga ankesa në fashikullin e ankesës së sipërcituar?*

II.10 Nëpërmjet shërbimit postar, është dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën përcjellëse me nr.3710/8 prot., datë 17.07.2026, protokolluar me tonën me nr.2058/5 prot., datë 20.07.2026

Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me nr. 129/2026, datë 16.07 2026, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues në procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar vendimit të KSHA-së nr.129/2026, datë 16.07 2026, rezulton se, kjo e fundit ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” SHPK.

II. 11. Operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK , nëpoërmjet shërbimit postar me shkresën me objekt *“Tërheqje nga ankesa”*, datë Korrik 2026, protokolluar me tonën me nr.2058/6 prot, datë 28.07.2026, ka paraqitu pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-82309-04-16-2026, me objekt: “Loti 2: “Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë”, me fond limit 99,351,968.95 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 08.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, duke u shprehur se: *Shoqëria "Pastrime Silvio" sh.p.k. me adresë rruga "Martin Camaj", pallati MGB, Tiranë, me përfaqësues ligjor Bule Allmuça, tërhiqet nga ankesa me nr. A/2026/6888, datë 26.06.2026 për vlerësimin e procedurës me objekt "Loti 2: "Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë”, nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara”*.

II.12. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues, “Pastrime Silvio” SHPK, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-82309-04-16-2026, me objekt: “Loti 2: “Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë””, me fond limit 99,351,968.95 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 08.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

II.1.1 Operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK , nëpoërmjet shërbimit postar me shkresën me objekt *“Tërheqje nga ankesa”*, datë Korrik 2026, protokolluar me tonën me nr.2058/6 prot, datë 28.07.2026, ka paraqitu pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me REF-82309-04-16-2026, me objekt: “Loti 2: “Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë”, me fond

limit 99,351,968.95 lekë pa tvsh, zhvilluar me datë 08.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, duke u shprehur se: *Shoqëria "Pastrime Silvio" sh.p.k. me adresë rruga "Martin Camaj", pallati MGB, Tiranë, me përfaqësues ligjor Bule Allmuça, tërhiqet nga ankesa me nr. A/2026/6888, datë 26.06.2026 për vlerësimin e procedurës me objekt "Loti 2: "Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë", nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara".*

III.1.2. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet:

"1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes."

III.1.3. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. KPP konstaton se, operatori ekonomik "Pastrime Silvio" SHPK, i cili ka paraqitur tërheqjen nga ankesa, është pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 2058/2026 prot., për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, "Pastrime Silvio" SHPK, në procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me REF-82309-04-16-2026, me objekt: "Loti 2: "Shërbimi i pastrimit të zonës bregdetare për Bashkitë Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë dhe Sarandë", me fond limit 99,351,968.95 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 08.06.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik, “Pastrime Silvio” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu